

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare 2023


20.10.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare për vitin 2023.

### Qasje e lartë në TIK në Ekonomitë Familjare


Sipas rezultateve të Anketës TIK në Ekonomitë Familjare përqindja e ekonomive familjare që kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2023 është rreth 98,6%. Ndërkohë që, 0,8% e ekonomive familjare kanë deklaruar se nuk kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2023.

#### Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet




#### Grup-moshat që kanë pasur qasje në internet

Grup-mosha me përqindjen më të lartë të qasjes në internet është grup mosha 16-24 vjeç me rreth 21,5%, pasuar nga grup-mosha 25-34 vjeç me 21,4%, ndërkohë me përqindjen më të vogël të qasjes në internet është grup-mosha 65+ me rreth 7,9%.



### Përdoruesit e internetit sipas gjinisë në %


Përdorimi i internetit nga femrat dominon me 51,7%, krahasuar me meshkujt me 48,3%.



### Pajisjet e përdorura për t'u qasur në internet në %

Sipas Anketës TIK në Ekonomitë Familjare del se 94,8% e individëve kanë përdorur telefon mobil/telefona smart për t'u qasur në internet; 22,1% kanë përdorur laptop; 11,9% kanë përdorur kompjuter / desktop; dhe 9,7% kanë përdorur tablet. Ndërkohë që, 39,8% e individëve kanë përdorur pajisje të tjera për të hyrë në internet.

**Pajisjet për qasje në internet në %**



Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Rezultateve të Anketës TIK në ekonomi familjare 2023, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/LivingConditions>